



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 02
Prishtinë, më 25 janar 2013, në orën 09:00, salla N-303
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Halilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Ramiz Lladrovci.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatore; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kelmendi-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.01.2013**
3. **Shqyrtimi i propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2013,**
4. **Te ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.01.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.01.2013

3. Shqyrtimi i propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2013

Kryetari – Në takimin e sotëm është planifikuar të shqyrtohet draft plani i punës së Komisionit i cili në vete përfshinë edhe planin financiar dhe angazhimin e eksperteve për vitin 2013.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm akoma nuk ka dorëzuar planifikimin kohor për dorëzimin e raporteve të auditimit dhe pa këtë planifikim në draft planë janë prezantuar vetëm shqyrtimi i raporteve të auditimit pa ndonjë specifikim se çfarë raporti në çfarë kohe, apo i cilës Organizatë Buxhetore.

Stafi i Komisionit ka përgatitur një draft plan me aktivitete të cilat janë të shpërndara nëpër të gjithë muajt e vitit 2013.

Sipas këtij draft plani është paraparë shqyrtimi i raportit vjetor të performancës së ndërmarrjeve publike, pastaj shqyrtimi i raporteve kthyesë të OB sipas kërkesës së Komisionit, shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të përgjithshëm. Përzgjedhja e kompanisë audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it për vitin 2012. Janë planifikuar edhe shqyrtimi i raportit të performancës së ZAP-it si dhe shqyrtimi i raportit të NJQHAB. Në gjashtëmujorin e dytë, është paraparë, shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit i cili në vete përmban raportet e Institucioneve qendrore, Lokale dhe agjensioneve të pavarura dhe të Ndërmarrjeve Publike. Në kuadër të kësaj janë planifikuar dy dëgjime publike, njeri për shqyrtimin e raporteve të auditimit të komunave dhe tjetri për shqyrtimin e raportit vjetor të auditimit. Po ashtu me këtë draft plan është paraparë vizita në dy Organizata Buxhetore. Në përputhje me këtë draft-planin të punës është përgatitur edhe draft plani financiar i buxhetit të Komisionit për vitin 2013.

Buxheti i Komisioni është 5,000 euro, dhe i njëjti është planifikuar për angazhim të eksperteve, dëgjime publike, vizita në OB dhe shpenzime të paplanifikuara që mund të dalin gjatë aktiviteteve të Komisionit, duhet cekur se ky planifikim i buxhetit është bere pa ndonjë bashkëfinancim me partneret e komisionit sepse deri më tani akoma nuk kemi konfirmim te tyre nëse do të jenë pjese e aktiviteteve të komisionit ose jo. Plani i punës së komisionit dhe plani financiar, janë shumë fleksibil dhe kjo mund të ndryshoj gjatë vitit. Lidhur me azhurnimin e listës së eksperteve, propozoi që lista e eksperteve të mos ndryshoj, por edhe sipas Udhëzimit Administrativ për çështjet e caktuar gjatë vitit mund të angazhohjmë ekspert nga lëmia e caktuar. Për shqyrtimin e raporteve të ndërmarrjeve publike, në mbledhjen e kaluar mora konfirmimin që të vazhdoj të jete eksperti i angazhuar vitin e kaluar. Hapi diskutimin.

Murselj Haljilji – Sipas planit të ZAP-it, parashihet një numër i madh i raporteve në muajin prill. Pyeti: A mund të dorëzohen këto raporte në Prill në Komision, për shqyrtim. Domethënë a janë këto data apo planifikime të sakta.

Imri Ahmeti – Draft plani i punës së Komisionit është një bazë e mirë për punën e Komisionit. Plani kohor i dorëzuar nga ZAP-i nuk është i inkorporuar, ndoshta duhet të autorizohet stafi që të inkorporoj atë pasi që i njëjti është dorëzuar sot. Aktivitetet e Komisionit të paplanifikuara mund të inkorporohen gjatë vitit. Përkrah propozimet për plan të punës.

Valbona Dibra – Kërkoi sqarime nga ZAP-i, lidhur me auditimin e performancës të planifikuar për muajin shkurt 2013. Pyeti: për çfarë auditimi është fjala? Për vitin 2012, apo 2011?

Auditimi i performancës “bursat qeveritare” - Kosova ka probleme shumë më të mëdha për auditim të performancës, se sa bursat qeveritare, kjo nuk është shumë çështje materiale. Komisioni ka rekomanduar auditimin e disa ministrive. E kemi parasysh që nuk mund të bëhet auditimi i performancës për gjithë ministrinë. Por, p.sh është dashur të jetë planifikuar një auditim i performancës për sektorin farmaceutik dhe për pajisje medicinale dhe i propozoi Komisionit që të dal me një rekomandim lidhur me këtë, për ZAP-in.

Komisioni duhet të përfshijë në plan edhe vizitat jashtë vendit. Duhet diskutuar këtë çështje me partnerët e Komisionit. Ky Komisioni është i ri dhe ka nevojë për praktikatat e shteteve të tjera.

Sa i përket listës së ekspertëve, mund të mbetet e njëjta dhe anëtarët e Komisionit, mund të propozojnë dikë, por ai që propozohet duhet ti nënshtrohet procedurave të votimit në Komision, ashtu siç i janë nënshtroar edhe ekspertet e tjerë.

Insistoi në atë se kërkesat e Komisionit duhet të merren për bazë gjatë hartimit të planit të

punës së ZAP-it. ZAP ka kapacitete për auditim të performancës, sepse ka staf që punon në ZAP që nga viti 2003. ZAP-i edhe më parë ka kryer auditime të performancës në sektorin farmaceutik. Pastaj, Komisioni në vazhdimësi ka përkrahur ZAP me ngritje të kapaciteteve.

Kryetari - Problemet që do të duhej të kenë auditim të performancës janë: në shëndetësi do të duhej të auditoheshin investimet kapitale dhe barnat; në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - librat dhe puna jashtë orarit; Ministrinë e Administratës Publike - pagat, pastaj Ministria e Zhvillimit Ekonomik si aksionare nuk ka mbajtur mbledhje të aksionarëve.

ZAP në këtë mënyrë mund të identifikoj fushat specifike për auditim të performancës. Komisioni gjatë gjithë vitit ka ngritur këto shqetësime dhe këto është dashur të përfshihen në planin e ZAP-it.

Në Kuvend është ngritur çështja se Komisionit për Miniera dhe Minerale: gazeta në bote kanë bërë komente të cilat janë negative për investitorët e huaj. Nëse ZAP do të ketë mundësi të bëjë një vështrim të asaj materie, për ta njoftuar pastaj Kuvendin për gjendjen në këtë institucion.. në këtë mënyrë edhe ata duhet ta kuptojnë se dikush po përcjellë punë e tyre.

Artan Venhari. Zëvendës auditor –Datat e planifikuara për dorëzim janë të sakta dhe sipas të cilave ZAP do të procedoj raportet. Raporti i cili do të publikohet në muajin shkurt është filluar në vitin e kaluar dhe tashmë është në fazën përfundimtare.

Numri i raporteve që nuk janë të rregullsisë janë në ngritje. Auditimi i sektorit farmaceutik është në procedurë. Pastaj, ZAP-i mirëpret identifikimin e problemeve nga Komisioni për auditim të performancës. Duhet të mendoj në identifikimin e problemeve e pastaj të mendojmë për auditimin e atyre problemeve. Fatkeqësisht edhe për shkak të ndryshimit të ligjeve disa nga fusha nuk do të mund të auditojmë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Plan i Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2013.*
2. *Miratohet Plan Financiar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2013.*
3. *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të bëjë auditimin e performancës në sektorin farmaceutik dhe të pajisjeve medicinale.*

Lidhur me azhurnimin e Listës së Ekspertëve për vitin 2013, Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

VENDIM

1. Lista aktuale e ekspertëve e azhurnuar vitin e kaluar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, mbetet në fuqi.
2. Listën e ekspertëve për aktivitetet e Komisionit për vitin 2013, e përbëjnë: Jusuf Kryeziu, Ujkan Bajra, Mentor Ramosaj, Albert Krasniqi, Xhevat Meha, Mustafë Hasani, Rustem Asllanaj, Ali Latifi, Haki Shatri, Bashkim Zeqiri, Hysen Ismaili dhe Safet Merovci.
3. Për çështje të caktuara, Komisioni mund të angazhoj ekspert që nuk është përfshirë në listë. Kjo në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve Parlamentare.
4. Termat e referencës, nënshkruhen nga kryetari i Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu